

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Data 30.03.2026

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje matesa, perfshire aksesoret e nevojshem”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 38426000-7 - Matës i ngarkesave elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës:

1. **395,624,100** (treqind e nentdhjete e pese milion e gjashteqind e njetzet e kater mije e njeqind) **Lekë pa TVSH.**
2. **4,120,655.14** (kater milion e njeqind e njetzet mije e gjashteqind e pesedhjetë e pese pike e katermbedhjetë) **Euro pa TVSH. (kursi i kembimit ne daten 30.03.2026, 1 euro=96.01 leke).**

1.

Ndarja ne lote: nuk ka

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Procedura e prokurimit me “**Blerje matesa, perfshire aksesoret e nevojshem**” ka per qellim blerjen e matesave qe i nevojiten Autoritetit Kontraktor per matjen e energjise elektrike ne funksion te objektit te aktivitetit te saj per shperndarjen e energjise elektrike. Referuar procedures se prokurimit , AK vlereson se kjo procedure prokurimi nuk mund te ndahet ne Lote per arsye:

Duke ndarë mallrat në lote , mund të kemi më shumë kontrata dhe kontraktorë të ndryshëm për të menaxhuar. Kjo mund të sjellë sfida dhe kosto në menaxhimin e kontratave.

Në raste të ndarjes në lote , mund të ketë më shumë problematika në monitorimin e cilesise të çdo artikulli dhe në koordinimin e transportit dhe furnizimit. Një listë e vetme mund të reduktojë këto problematika dhe kompleksitetin ne furnizim

Një listë e vetme e mallrave mund të promovojë konkurrencën më të lirë midis ofruesve, pasi ata do të kenë mundësinë të ofrojnë për të gjitha mallrat e nevojshme, duke përmirësuar mundësinë për të siguruar ofertat më të mira në çdo kategori.

AK është një institucion i rëndësishëm në sistemin elektro-energjetik shqiptar dhe gjithashtu ben edhe shpërndarjen e energjisë elektrike dhe për këtë arsye vonesat në furnizimin e mallrave objekt prokurimi sjell shumë problematika.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë me vlerë jo më të vogël se 100% i vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe

nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumen e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal për shlyerjen e taksave vendore për tremujorin e parë të maturuar të vitit 2026 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Ky kriter te permbushet nepermjet paraqitjes se formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas Shtojces Nr.9 te DST-së. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetedeklarimit të kryer në Shtojcën Nr. 9 të DST-së.

Argumentim: Ne lidhje me kërkesen per pagesen e taksave vendore referojme se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit per te paraqitur dokumentacionin e shlyerjes se taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë te vertetojne se ushtrojne aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave të kërkuar në këtë objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të kete realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK krijon siguri dhe besueshmëri që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.4 Dokumentacioni

Per mallrat

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit / distributorit për artikujt e kërkuar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Argumentim: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve. Ky kriter ka disa arsye:

Së pari, paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën përkatëse. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në tregun e Shqipërisë. Përmes

këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte.

Së dyti, kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Së treti, kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

*Gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të **Rekomandimit nr.787 prot. Datë 23.01.2026 të Agjensisë së Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore **“Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik”**.*

2. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut /eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë e katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin. Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyera në shqip dhe të noterizuara

Argumentim: Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut është një hap i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Së pari, paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të artikujve. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e artikujve që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Së dyti, kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Fragmentet e katalogut tregojnë se operatori ekonomik ka kujdes për detajet dhe është i përkushtuar ndaj cilësisë dhe pajtueshmërisë.

Së treti, kriteri për përkthimin dhe noterizimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e bleresit. Përkthimi dhe noterizimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të artikujve. Kjo ndihmon në zvogëlimin e gabimeve dhe keqkuptimeve të mundshme gjatë furnizimit të mallrave.

Kërkesa për katalogun /skedën teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmërinë me specifikimet teknike e cila siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara

Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij

3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për artikujt e kërkuar, objekt prokurimi, të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e mallrave të prodhuara me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kjo kërkesë është në përputhje me piken 6/c, të nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e dëshmive të testimeve zyrtare është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar cilësinë dhe pajtueshmërinë e mallrave të blera me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara.

Së pari, paraqitja e dëshmive të testimeve zyrtare siguron një burim të besueshëm të informacionit për cilësinë e mallrave. Testimet zyrtare janë kryer nga institucione të pavarura dhe të autorizuar ose nga prodhuesi i vetë mallrave, duke garantuar pavarësinë dhe besueshmërinë e rezultateve. Ky informacion është i rëndësishëm për AK për të siguruar që mallrat janë të pajtueshme me specifikimet dhe standardet e kërkuara.

Së dyti, kriteri për deshmite e testimave zyrtare ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve. Duke përdorur informacionin e testimave zyrtare, AK mund të identifikojë përparësitë dhe mangësitë e çdo oferte potenciale. Kjo i ndihmon të bëjë një zgjedhje të informuar .

Së treti, duke kërkuar paraqitjen e deshmive të testimave zyrtare, AK mund të sigurojë që të gjithë operatorët ekonomikë kanë një mundësi të barabartë për të demonstruar cilësinë dhe pajtueshmërinë e mallrave të tyre.

4. Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, **OSE EKVIVALENTE** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

Argumentim: Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterit për operatorin ekonomik ofertues të pajisur me Certifikatën ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë është një hap i arsyeshëm dhe i nevojshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e punës dhe zbatimin e kontratës.

Së pari, Certifikata ISO 9001 tregon se operatori ekonomik është i përkushtuar ndaj cilësisë dhe menaxhimit të proceseve. Ky standard ndjek një qasje sistematike dhe të dokumentuar për të menaxhuar cilësinë në të gjitha fazat e procesit të prodhimit ose shërbimit. Përdorimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë të bazuar në ISO 9001 siguron që operatori ekonomik është në gjendje të identifikojë, monitorojë dhe korigjojë problemet e cilësisë në mënyrë efikase.

Së dyti, ky kriter siguron që operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë standartet e kërkuara dhe specifikimet teknike të tenderit. Certifikata ISO 9001 paraqet një vërtetim të jashtëm të aftësisë së operatorit ekonomik për të kryer punën me cilësi të lartë dhe në përputhje me standarde të njohura ndërkombëtare.

Së treti, ky kriter siguron që operatori ekonomik është i aftë për menaxhim të mirë të punës dhe për të zbatuar efikasitetin operacional. Një sistem i menaxhimit të cilësisë sipas ISO 9001 përfshin procedura të dokumentuara dhe një qasje të planifikuar ndaj risqeve. Kjo ndihmon në planifikimin e mirë të furnizimit të mallrave dhe në parandalimin e gabimeve dhe dështimeve të mundshme gjatë punës.

5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetedeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kërkuara.

Argumentim: Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të paraqesë vetedeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001 dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kërkuara, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propozicion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Kërkesa në lidhje është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklarate konformiteti ku të shprehet që materialet të kenë markim CE.

Argumentim Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku shprehimisht citohet: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe pika 8 e nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambjentet e Autoritetit Kontraktor përfitues. Certifikatat e konformitetit CE janë dokumente të rëndësishme që vërtetojnë përputhjen e produkteve me standardet e sigurisë dhe cilësisë..

Vendosja e kriterit të markimit CE është një hap i rëndësishëm për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e mallrave të blera.

Së pari, markimi CE është një dëshmi e qartë e pajisjes me artikuj të përshtatshëm për përdorim në tregun evropian. Ky markim tregon se mallrat janë prodhuar dhe testuar në përputhje me standarte të caktuara evropiane për cilësi dhe siguri. Për shkak të kësaj, vendosja e kriterit të markimit CE siguron që operatori ekonomik të ketë mallra që plotësojnë këto standarte dhe janë të sigurta për përdorim.

Së dyti, markimi CE promovon konkurrencën e drejtë në treg. Nëse operatorët ekonomikë nuk janë të detyruar të paraqesin deklarata të konformitetit me këtë kriter, atëherë ka rrezik që disa prej tyre të përdorin mallra të cilësisë së ulët ose të rrezikshme. Kjo mund të shkaktojë jo vetëm rreziqe

për punonjësit, por edhe konkurrin të padrejte për ata operatorë ekonomikë që kanë investuar në mallra cilësore dhe të sigurt.

Së treti, markimi CE është i rëndësishëm për përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret. Në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian, veglat e punës janë të detyruara të plotësojnë këto standarde të sigurisë.

7. Për zerin vule sigurie duhet të paraqitet vertetimi i miratimit të vules nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM).

Argumentimi: Kriteret e kualifikimit vendosen që ti shërbejnë AK-se sipas referimeve të VKM Nr 285 datë 19.05.2021 neni 40 paragrafi 8 i të cilit përcakton: Autoriteti Kontraktor përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta në varesi të objektit që prokurohet të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Duke qenë se ekzekutimi me sukses i kësaj kontrate është shumë i rëndësishëm për AK pasi vulat e sigurisë janë një mall që duhet të jetë gjithmonë gjendje në magazine për aktivitetin normal të kompanisë në lidhje me sistemin e matjes, kërkohej nga AK miratimi paraprak në DPM i vules që do furnizohej në mënyrë që të mos deshtojë realizimi i kontratës pasi legjislativi në fuqi kërkon domosdoshmërisht që vulat të përdoret për matësat e energjisë të jenë të miratuara nga drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM).

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 36 muaj nga data e dorëzimit). Koha minimale për eliminimin e defekteve për zbatimin e periudhës së garancisë është vendosur brenda 30 ditëve pune, ose brenda 14 ditëve pune për t'i ndërruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 40, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Pavaresisht se si kriter kualifikues janë përcaktuar paraqitja e dokumentacionit specifik teknik vetëm për tre artikuj, në specifikimet teknike mund të kërkohej (nese ka) që disa nga produktet të plotësojnë kërkesat e disa standardeve specifike, Operatori ekonomik duhet të deklarojë që produkti që premtonte të furnizohej “plotëson kërkesat e standardeve të cituara në shtojcën e specifikimeve teknike dhe nëse shpallet fitues me dorëzimin e mallit ai duhet të dorëzojë pranë AK certifikatat respektive.

Duke qenë se cilësia e produktit nuk mund të verifikohet vetëm nga pamja dhe prezantimi në natyrë të produkteve por në shumë raste nga kryerja e analizave, inspektimeve profesionale dhe testimet, kjo kërkesë është kërkesë normale, ligjore, në kompetencë ligjore edhe të AK për të ushtruar kontroll mbi verifikimin e cilësive të produktit.

9. Operatori ekonomik per artikujt e poshteshenuar:

- Matësa 230V; 5-100 A (redy smart)
- Matësa 3x 230/400V ; 5-100 A (redy smart)
- Mates elektronik te gatshem per lexim ne distance 3x230/400V 5(6)A

Diten dhe oren e hapjes se procedures, duhet të paraqesë nga një mostër të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara ne shtojcë “Specifikimet Teknike” të DST-së.

Per cdo artikull “moster” te dorezuar, duhet qe te jete bashkelidhur me mostren etiketa e firmosur dhe vulosur me treguesit kryesore te kompanise dhe procedures.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë (te vleresojne dhe krijojne idene) se mallrat e ofruara prej tyre plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit. Duke marrë parasysh llojin e mallrave objekt prokurimi, Autoritetin Kontraktor ka perzgjedhur nga lista e mallrave 3 artikuj me ate te se cileve do te vleresohet mundesia qe operatori ekonomik te demostroje cilesine teresore te pritshme te mallrave.

10. Operatori ekonomik duhet te deklaroje sipas tabelës për mallrat objekt prokurimi.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit	Prodhuesi/ Distributori i autorizuar nga prodhuesi
1			
2			
Etj.,			

Argumentimi: Me ane te kerkeses se mësipërme e cila eshte mbeshtetur bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, AK gjykon se per cdo artikull vleresohet realisht aktiviteti qe merr persiper te realizoje operatori ekonomik pra OE respektiv do te jete ne rolin e tregetuesit, vleresohet origjina e produktit duke

marre nje informacion edhe mbi reputacionin e prodhuesit te pare, si dhe gjykon mbi riskun qe mund te kete realizimi i kontrates nga perfshirja ne realizimin e kontrates e subjekteve te tjera qe ne shume raste nuk jane me aktivitet ne Shqiperi.

Paraqitja e Autorizim Prodhuesi/Autorizim Distributori/Konrate furnizimi me te dhenat e kompanise qe do te realizoje furnizimin rrit besueshmerine, detyrimin, si dhe eshte baze per te garantuar realizimin e kontrates.

11.Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Ames, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

12. Bazuar ne parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar, ku ne pikën 6 te nenit 26 parashikohet:

- *Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” te pikës 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertës, te dorëzuara ne rrugë elektronike. Këto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njësuara me origjinalin.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Specifikimet teknike dhe preventivi janë hartuar nga OSSH sh.a qender dhe dërguar me shkresë në Drejtorinë Rajonale Tirane e OSSH sh.a. Perlllogaritja e Fondit Limit , afati i levrimit është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdher të posacem nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë:

Data 30.03.2026 Ora 11.00

Vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

Njesia e Prokurimit